



Në bazë Vendimit për përcaktimin e nevojës për realizimin e Thirrjes publike për dhënien e së drejtës për shfrytëzimin e përkohshëm të sendit të paluajtshëm-banesë, pronësi e Qytetit të Shkupit (“Lajmëtari Zyrtar i Qytetit të Shkupit” numër 13/25), Qyteti i Shkupit shpall:

THIRRJE PUBLIKE
për dhënien e së drejtës për shfrytëzimin e përkohshëm të sendit të paluajtshëm-banesë,
pronësi e Qytetit të Shkupit

I. Lëndë e Thirrjes Publike:

Lënda e thirrjes publike është dhënia e së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm – banesë, pronësi e Qytetit të Shkupit, një shoqate ose fondacioni që punon në fushën e parandalimit të dhunës në familje dhe kujdesit për viktimat e dhunës në familje.

II. Korniza kohore për shfrytëzimin e sendit të paluajtshëm – banesë

Sendi i paluajtshëm - banesë, do të jepet në shfrytëzim për një periudhë prej një (1) viti.

III. Kushte për pjesëmarrje në Thirrjen publike

Aplikantët të cilët marrin pjesë në Thirrjen publike duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Të jenë regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të punojnë në aktivitete dhe projekte në fushën e kujdesit dhe parandalimit për viktimat e dhunës në familje;
- Të kenë përvojë në fushën e mbrojtjes sociale minimum pesë vjet;
- Të menaxhojë me shërbim të specializuar për ndihmë dhe mbështetje për dhunën në punë.

IV. Mënyra e aplikimit për Thirrjen publike

Aplikantët që marrin pjesë në këtë thirrje publike janë të obliguar të depozitojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular i plotësuar për projekt propozimin (në dispozicion në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk);
- Aktvendim për regjistrimin e aplikantit të lëshuar nga Regjistri Qendror;
- Fotokopje e llogarisë përfundimtare për vitin fiskal të kaluar;
- Kopje e Statutit të aplikantit;
- Vërtetim për tatime të paguara të lëshuar nga autoritetet tatimore.

Aplikantët mund të depozitojnë dokumentacionin shtesë si më poshtë, i cili do të konsiderohet si përparësi:

- Biografite profesionale të ekspertëve që do të angazhohen në zbatimin e projektit;

- Listë referencash ose dëshmi (shembull: kontratë e nënshkruar) për të paktën 2 projekte të realizuara në fushën për të cilën aplikohet;
- Të paktën 2 mendime (referenca) nga partnerë ose donatorë për zbatimin e projekteve të mëparshme;
- Mbështetje me shkrim nga organizata dhe/ose institucione të tjera që janë planifikuar të marrin pjesë në realizimin e projektit.

V. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

Për të përcaktuar përmbushjen e kushteve dhe kompetencën e dokumentacionit të paraqitur nga thirrja publike, kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për realizimin e Thirrjes publike për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm - banesë, pronësi e Qytetit të Shkupit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni).

Aplikimet e depozituara jo në kohë, të parregullta (të palexueshme) ose të paplota dhe që nuk i plotësojnë kushtet, Komisioni nuk do t'i marrë në konsideratë, gjë për të cilën do të informojë aplikantët, aplikimet e të cilëve janë refuzuar.

Për aplikimet e plota, të depozituara në kohë dhe që plotësojnë kushtet, Komisioni i paraqet kryetarit të Qytetit të Shkupit listë renditjeje të propozuar për përzgjedhjen e aplikantit për dhënien e së drejtës së shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm - banesë.

Kryetari i Qytetit të Shkupit, me propozim të Komisionit, miraton Aktvendim me të cilin i jep të drejtën e shfrytëzimit të përkohshëm të sendit të paluajtshëm-banesë aplikantit të renditur më mirë. Qyteti i Shkupit lidh kontratë me aplikantin e përzgjedhur, me të cilën rregullohen të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve kontraktuese në bazë të shfrytëzimit të sendit të paluajtshëm pronësi e Qytetit të Shkupit.

VI. Mënyra dhe afati i depozitimit të aplikimeve

Afati i fundit për depozitimin e aplikimeve është 17.12.2025, deri në orën 15:00 часот.

Aplikimi me të gjithë dokumentacionin duhet të depozitohet në Arkivin e Qytetit të Shkupit (bul. "Ilinden" nr. 82, Shkup) në zarf të mbyllur me shënimin: Për Komisionin për zbatimin e Thirrjes publike për dhënien e së drejtës së përdorimit të përkohshëm të pronës së paluajtshme - banesë/Aplikim për Thirrje Publike)

Aplikimet e depozituara nëpërmjet adresës e-mail nuk do të shqyrtohen.

Formulari i propozimit të projektit është në dispozicion në faqen e internetit të Qytetit të Shkupit. www.skopje.gov.mk.

Pjesëmarrësit në Thirrjen Publike do të njoftohen për rezultatet brenda 5 ditëve nga data e miratimit të Vendimit për dhënien e sendit të paluajtshëm - banesë.

Për informacione plotësuese:

Pyetjet për sqarime mund të bëhen me shkrim ose në mënyrë elektronike pranë Seksionit të mbrojtjes sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore.

Kontakt: Seksioni për mbrojtje sociale, të fëmijëve dhe shëndetësore, tel: 02/ 3297 278 dhe 02/ 3297 321 ; E-mail: socijala@skopje.gov.mk.